Kronikë

VIDEO/ Të maskuar dhe me armë zjarri, arrestohen tre të rinjtë në Lushnjë, tentuan të vjedhin një banesë

Tre të rinj kishim planifikuar të vidhnin një banesë në fshatin Bubullimë në Lushnjë, por plani nuk u shkoi siç duhej. Banorët e fshatit i kishin parë të maskuar që po shkonin në drejtim të një banesë në fshat dhe kishin lajmëruar policinë.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
1 Korrik, 09:35 | **Përditesimi: 1 Korrik, 10:00**

LUSHNJË- Tre të rinj kishim planifikuar të vidhnin një banesë në fshatin Bubullimë në Lushnjë, por plani nuk u shkoi siç duhej. Banorët e fshatit i kishin parë të maskuar që po shkonin në drejtim të një banesë në fshat dhe kishin lajmëruar policinë. Gentian Bajrami, 22 vjeç, dhe Ramazan Troka, 29 vjeç, u arrestuan në banesën që ishin futur për të vjedhur, ndërsa në pranga ra edhe një 30-vjeçar, i cili i ka lëvizur me makinë.

Po ashtu, njëri prej të rinjve ishte i pajisur me pistoletë, ndërsa kjo vjedhje mund të kishte përfunduar edhe me pasoja fatale për jetën, por fatmirësisht u shmang. Bajrami dhe Troka u kapën në flagrancë në oborrin e banesës ku donin të vidhnin, pa hyrë ende në brendësi të saj. Ndërkohë, Volter Alushaj i kishte dërguar me makinë deri në zonën ku kishin planifikuar vjedhjen dhe po i priste ata në vendin e quajtur "Rotondoja e Kolonjës", për t'i marrë sërish, pas kryerjes së krimit.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
VIDEO/ Aksident në aksin Fier-Lushnjë! 'Benz-i' kundërvajtje në autostradë

Policia ka sekuestruar 1 armë zjarri pistoletë me 1 krehër me municion luftarak, 2 maska, doreza plastike dhe 10 lidhëse plastike të lidhura në formë prangash. Ndaj tyre rëndojnë akuzat për veprat penale "Vjedhje me armë", mbetur në tentativë dhe kryer në bashkëpunim, si dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Volter Alushaj | Ramazan Troka | Gentian Bajrami | Fier | lushnje

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
A mendoni se dixhitalizimi i Kadastrës do i japë fund abuzimeve me pronat?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Çmimi i ulët, qindra ton grurë 'rrugëve' të Myzeqesë! Fermerët: Grumbulluesit fiksojnë çmimin! Me 2800 lek/kuintalë, nuk mbulojmë kostot
Kristaq Thano
Yrjet Saliasi
28 Qershor, 13:04

Kishte mbjellë 30 bimë narkotike, 37 vjeçari në Fier kapet 'mat' teksa ujiste kanabisin e kultivuar mes vreshtave me rrush (EMRI)
28 Qershor, 10:16

Për herë të parë ndër vite, besimtarët falin namazin në qendrën e qytetit të Fierit
28 Qershor, 07:45

Kremtohet festa e Kurban Bajramit në Korçë e Lushnjë, besimtarët myslimanë falin namazin
28 Qershor, 07:00

EMRAT/ Përplasen 2 motoçikleta në Lushnjë, dy të plagosur, njëri prej tyre në gjendje të rëndë
27 Qershor, 12:45

Kufiri 2.8 m, rezervuari i Fierit drejt tharjes! Inxhinieri Kola: Niveli i ujit kritike, rrezikohen tokat
Kristaq Thano
26 Qershor, 18:52

Fier, kombinimi i bujqësisë me blegtorinë prodhon sukses! Fermeri: Jam i kënaqur me treguesit
Kristaq Thano
25 Qershor, 19:17

I dehur në timon përplasi me makinë 45 vjeçaren, arrestohet shoferi në Fier
25 Qershor, 09:40

Prindërit në Fier e kërkonin që prej 2 ditësh, 14 vjeçarja gjendet në Tiranë
24 Qershor, 20:13

Festa e Grurit në Myzeqe, Balla: E rëndësishme të konsumojmë sa më shumë produktet shqiptare! Grumbulluesit të bëjnë prodhimin vendas
24 Qershor, 16:00

Fluks vizitash në pediatrinë e Fierit, mjekja: Viroza shfaq temperatura të larta, diarre dhe të vjella
Kristaq Thano
24 Qershor, 15:32

Rikthehet 'Festa e Grurit' në Fier! Tradita bën bashkë 3500 vizitorë, fermerët: Nuk kemi ku e çojmë prodhimin, s'ka treg shitje
Kristaq Thano
24 Qershor, 15:19

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje